

## AKT THEMELIMI

Sot ne dt. 22 Qershor 2021 me cilesine e " Ortakeve Themelues ",

**KRZYSZTOF ZUGAJ**, i biri i Edward(it) i datelindjes 25-03-1980, i lindur ne ZABKOWICE SLASKIE, POLONI, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr.FA8081318 ,leshuar nga WOJEWODA DOLNOSLASKI, Poloni me date 30.03.2022,

i cili me vullnet të lire të plote e të singerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin " Per QKB", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin **TradeAlb 2022** shpk.

### KREU I

#### Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

##### Neni 1

##### Emertimi

Emertimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **TradeAlb 2022** shpk. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

##### Neni 2

##### Forma Juridike

Shoqeria **TradeAlb 2022** shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria"). Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj. Shoqëria **TradeAlb 2022** shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaku i vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

##### Neni 3

##### Selia

#### Shoqeria e ka seline ne adresen:

#### **Lagjia nr.1, Rruga Gjergj Araniti, Godina nr.7, kati i pare, Sarande.**

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem.

##### Neni 4

#### **Objekti i veprimtarise**

- **Konsulent financiar.**

##### Neni 5

##### Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB).

### KREU II

#### KAPITALI

##### Neni 6

##### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10,000 lekë.

Kapitali i shoqerise eshte 10,000 leke i perbere nga 1 kuote dhe zoterohet nga ortaku i vetem i shoqerise si me poshte :

1. Ortaku Themelues: **KRZYSZTOF ZUGAJ**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 10,000 Leke, e cila perfaqeson 100 % te kapitalit te shoqerise.

Vlera totale e Kapitalit te Regjistruar **10,000 Leke.**

Vlera Totale e Kapitalit te Paguar **10,000 Leke**, do te paguhet ne avance nga ne ortaket. Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortakët pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;

#### Neni 7

#### Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

### KREU II

### ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

#### Neni 8

#### Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakut te vetem themelues eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise. Asambleja e Ortakut te vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Ortakut te vetem brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

#### Neni 9

#### Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator i vetem, i cili do te jete **KRZYSZTOF ZUGAJ**, i biri i Edward(it) i datelindjes 25-03-1980, i lindur ne ZABKOWICE SLASKIE, POLONI shtetas Polak, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr.FA8081318 ,leshuar nga WOJEWODA DOLNOSLASKI, Poloni me date 30.03.2022.

Emerimi i administratorit eshte me nje afat pese vjeçar me te drejte rimerimi, i cili ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e themelimit te shoqerise te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se ortakut te vetem te shoqerise.

#### Neni 10

#### Kompetencat

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Asamblese se ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e

statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratori ose ortakut që nuk janë persona juridikë nuk u lejohej të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua të shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

#### Neni 11

##### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### Neni 12

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilin është krijuar siç mund të jete

a. Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhimit të metejshëm të veprimtarisë së saj.

b. Në një nga menyrat e parashikuara nga ligji "Për Falimentimin"

c. Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Në këto raste Asambleja e Ortakut të vetëm merr vendim me shkrim në të cilin parashikon menyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër ".

#### Neni 13

##### Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këto akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këto akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil, Ligji për QKB, dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 14

##### Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në tre ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën italiane dhe pasi miratohet në parim dhe nën nën nga Ortaku i vetëm themelues i shoqërisë tregtare **TradeAlb 2022** shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale.

**ORTAKU I VETEM**

**KRZYSZTOF ZUGAJ**

